

## **Appendix C**

### ENTITLEMENT LETTER

I dashur prind/kujdestar:

Gjatë regjistrimit, ju plotësuar PyetëSORIN e Identifikimit të Gjuhës që Flitet në Shtëpi (Home Language Identification Survey, HLIS) për fëmijën tuaj, \_\_\_\_\_. Në bazë të përgjigjeve që dhatë në këtë pyetësor, fëmija juaj ka dhënë provimin e rishikuar të vlerësimit të nivelit të gjuhës me anën e krahasimit të grupeve të ngjashme (Language Assessment Battery-Revised, LAB-R) për të përcaktuar nivelin e tij ose të saj të kompetencës së anglishtes. Fëmija juaj mori vlerësimin \_\_\_\_\_ në LAB-R, që tregon se ai ose ajo i plotëson kushtet për të marrë shërbimet si një nxënës që mëson gjuhën angleze (English Language Learner, ELL), në një nga programet e mëposhtme:

- *Programi Dygjuhësor (Dual Language Program)* siguron gjysmën e mësimdhënies në anglisht dhe gjysmën në gjuhën e huaj të caktuar të programit (p.sh. spanjisht, kinezçe, haiti-kreole). Nxënësit e gjuhës së huaj të caktuar mësohen pranë nxënësve që flasin anglisht, në mënyrë që të gjithë nxënësit të edukohen në dy gjuhë dhe në dy kultura.
- *Në programin "Anglishte e Pavarur si një Gjuhë e Dytë" (Freestanding English as a Second Language Program)* të gjitha udhëzimet jepen në anglisht nëpërmjet përdorimit të metodave të veçanta të mësimdhënies.
- *Programi i Edukimit Dygjuhësor Kalimtar (Transitional Bilingual Education Program)* përfshin mësimdhënie në gjuhë dhe në lëndë të ndryshme mësimore në gjuhën amtare të nxënësit, si dhe mësimdhënie intensive në anglisht si një gjuhë e dytë. Kur nxënësi e zotëron më mirë anglishten duke transferuar gjuhën dhe aftësitë mësimore nga gjuha amtare, mësimdhënia në anglisht rritet dhe mësimdhënia në gjuhën amtare zvogëlohet.

Ju keni mundësinë për të bërë pyetje rreth programeve dhe shërbimeve arsimore që janë në dispozicion për fëmijën tuaj dhe të zgjidhni programin ku dëshironi ta keni fëmijën tuaj të regjistruar gjatë sesionit të orientimit të prindërve në \_\_\_\_\_ në \_\_\_\_\_. Ju lutemi sillni PyetëSORIN për Prindërit dhe Formularin e Përzgjedhjes së Programit (i cili është bashkangjitur në këtë letër). Mbas orientimit, do t'ju kërkohet të plotësoni këtë formular, me anë të të cilit do të bëni përzgjedhjen e programeve, në mënyrë që zgjedhja juaj e parë të jetë ai program në të cilin dëshironi më shumë që t'ju regjistrohet fëmija, edhe nëse nuk ofrohet tani në shkollën tuaj. Ky informacion do të na ndihmojë të krijojmë programe që u përgjigjen nevojave të prindërve. Ne ju nxisim që ta ndiqni orientimin, në mënyrë që të jeni të mirinformuar para se ta bëni përzgjedhjen tuaj. Megjithatë, nëse nuk keni mundësi ta ndiqni orientimin e planifikuar, ju lutemi telefononi

## **Appendix C**

### ENTITLEMENT LETTER

Koordinatorin e Prindërve, \_\_\_\_\_ në \_\_\_\_\_ për të caktuar një takim ose për të diskutuar në telefon mundësitë e programit. Pyetësi për Prindërit dhe Formulari i Përzgjedhjes së Programit përsëri duhet të plotësohet dhe të kthehet tek \_\_\_\_\_ brenda datës \_\_\_\_\_.

Ne do të bëjmë çdo përpjekje për të respektuar programin që zgjidhni për fëmijën tuaj. Megjithatë, prindërit që zgjedhin programin Arsimor Dygjuhësor Kalimtar, i cili nuk është në dispozicion në shkollën tonë, mund ta transferojnë fëmijën e tyre në një shkollë tjetër në atë distrikt që e ka një program të tillë. Lutemi vini re se sipas Pjesës 154 të Rregulloreve të Komisionerit të Arsimit për shtetin e Nju Jorkut dhe bazuar në kushtet që plotëson fëmija juaj, si minimum, fëmija juaj duhet të marrë pjesë në një program të Anglishtes së Pavarur si Gjuhë e Dytë.

Programi që zgjidhni për fëmijën tuaj do të jetë për të gjithë vitin shkollor \_\_\_\_\_. Plotësimi i kushteve të fëmijës suaj do të përcaktohet nga rezultatet e tij ose të saj në provimin e arritjeve të anglishtes si gjuhë e dytë të shtetit të Nju Jorkut (New York State English as a Second Language Achievement Test, NYSESLAT), i cili do të bëhet në pranverë. Është në interesin më të mirë të fëmijës suaj që ai të qëndrojë në të njëjtin program, për aq kohë sa i plotëson kushtet për këto shërbime. Studimet tregojnë se nxënësit që qëndrojnë në të njëjtin program nga viti në vit kanë rezultate më të mira në provimet e anglishtes së standardizuar dhe të matematikës, si në shkallë qyteti, ashtu edhe në shkallë shteti dhe se janë më të suksesshëm se ata nxënës që ndërrojnë programe të ndryshme.

Ne shpresojmë të kemi një vit shkollor frutdhënës për fëmijën tuaj në shkollën tonë. Nëse keni ndonjë pyetje në lidhje me mundësitë e programeve të fëmijës suaj, ju lutemi kontaktoni \_\_\_\_\_ në \_\_\_\_\_.

Sinqerisht,

\_\_\_\_\_